



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktures
Ministarstvo životne sredine, Prostronog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

**AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS**

**KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE**

**KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY**

PLANI PËR INTEGRITET

2024 - 2026

Përmbajtja

Hyrje

- 1.** Deklarata për Integritet
- 2.** Parimet e menaxhimit të Integritetit
 - 2.1** Lidershipi
 - 2.2** Përfshirja e personelit
 - 2.3** Qasja sistemore
- 3.** Objektivat e Planit të Integritetit
- 4.** Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit
 - 4.1** Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit
 - 4.2** Metodologjia e vlerësimit të rrezikut
 - 4.2.1. Matrica e vlerësimit të rrezikut
 - 4.2.2. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut
- 5.** Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi
- 6.** Fushat e rrezikut
 - 6.1** Fushat e përgjithshme të Rrezikut
 - 6.1.1. Drejtimi dhe menaxhimi i të punësuarve
 - 6.1.2. Planifikimi dhe menaxhimi financiar
 - 6.1.3. Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve
 - 6.1.4. Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve
 - 6.2** Fushat e Veçanta të Rrezikut
 - 6.2.1. Auditimi i brendshëm
 - 6.2.2. Prokurimi publik
 - 6.2.3. Ofrimi i shërbimeve për palët e jashtme
 - 6.2.4. Komunikimi me palët e jashtme të interesit
 - 6.2.5. Monitorimi i gjendjes së mjedisit
 - 6.2.6. Administrimi i parqeve kombëtare

Hyrje

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe “Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, AMMK, harton dhe miraton Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të organizatës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së një organizate dhe ekspozimin e saj ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të AMMK. Plani rithekson përkushtimin e AMMK për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah klienti. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të AMMK dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një organizate individuale;
- Vlerësimin e çfarëdo lloji rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një organizatë individuale; dhe
- Përcaktimin e masave për të zvogëluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit.

Plani i Integritetit pritet të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritjen e mundësive që AMMK të arrijë objektivat e saja organizative duke vënë përpara një menaxhim pro-aktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë/eliminojë mundësitë për korrupsion.
- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë AMMK të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponueshme kundër korrupsionit në mënyrë që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;
- Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet përkatëse ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsionit përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimi, si dhe duke inkurajuar një bashkëpronësi të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Rritjen e mëtejshme të besimit të palëve të brendshme dhe të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga AMMK.

Me zbatimin e këtij Plani, AMMK do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të përmirësuara për publikun dhe rritje të kënaqshme nga ana e palëve të interesuara. Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga AMMK. Prosesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të organizatës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikat dhe përfshirjen e stafit.

1. Deklarata për Integritet

Ne, në vazhdimësi bëjmë përpjekje të fuqishme për të rritur efikasitetin, trajtimin dhe cilësinë e shërbimeve dhe kryerjen e punëve profesionale, dhe kështu në mënyrë të dukshme dhe të konsiderueshme, përmirësojmë informimin për politikbërësit dhe për publikun.

Ne jemi të vetëdijshëm për mundësitë e sjelljeve keqpërdoruese dhe korruptive, për shkak të fushës së gjerë të ofrimit të shërbimeve dhe të shpenzimeve të buxhetit të planifikuar vjetor. Ekziston një potencial serioz për ushtrim të parregullt të pushtetit të monopolit të cilin ne duhet ta menaxhojmë me llogaridhënie, me përgjegjësi dhe me efikasitet.

Ne gjithashtu e kuptojmë mirë mandatin tonë për ta luftuar korrupsionin në nivel të organizatës. Organet drejtuese të AMMK janë të vendosur të zbatojmë me vendosmëri politikën “zero tolerancë” ndaj korrupsionit, kur ai zbulohet dhe të sigurojë se korrupsioni, mashtrimi, keq administrimi apo çdo shkelje tjetër e integritetit apo e ndonjë natyre të ngjashme nuk do të tolerohet.

Të gjitha shkeljet e mundshme do të hetohen, dhe ndaj atyre që janë përgjegjës do të merren masa. Këtu hyjnë edhe ngritja e akuzave penale, veprimet administrative dhe korrigjime sipas nevojës.

Është përgjegjësi e të gjithë stafit tonë që të gjitha incidentet e mashtrimit dhe të korrupsionit, apo shkeljet e tjera të integritetit me natyrë të ngjashme t’i raportojë tek mbikëqyrësit e tyre. Një tjetër mënyrë raportimi do të bëhet përmes paraqitjes së informacionit përmes mekanizmit të caktuar për paralajmërim. Këto do të trajtohen me konfidencialitetin më të thellë dhe nuk do të zbulohen apo diskutohen me palë të tjera përveç atyre që janë ngarkuar me hetimin e këtyre raportimeve. Në mënyrë që të sigurohen informata nga burime të ndryshme të mbikëqyrjes së qytetarëve, ne inkurajojmë të gjithë ata që kanë informacione për korrupsion apo shkeljeve tjera të integritetit, të raportojnë përmes linjën telefonike kundër korrupsion si një mekanizëm funksional për raportim.

Ne do të bëjmë përpjekje të vazhdueshme të përcaktojmë ekspozimet e mundshme të organeve të administratës së AMMK, kushteve të tyre organizative, proceseve dhe punonjësve, ndaj korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe jo etike. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën kundër-korrupsion në punën e drejtorive të AMMK. Përmes planit të integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korrupsionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve në punën e organeve të administratës shtetërore.

Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin e efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në organizatën tonë.

Ne jemi të vendosur që:

- në realizimin e mandatit dhe detyrave tona të veprojmë ndershëm, guximshëm, të matur, moralshëm, drejtë dhe me profesionalizëm.
- të mos përdorim asnjëherë detyrën zyrtare si dhe qasjen e besuar në resurset publike, duke përfshirë qasjen në informata për përfitime personale për ne apo të tjerët, apo për qëllime të avancimit në detyrë.
- të ndërmarrim të gjithë hapat e nevojshëm për të parandaluar dhe zgjidhur çfarëdo konflikti real, të dukshëm apo potencial të interesit ndërmjet përgjegjësive tona zyrtare dhe çështjeve tona private në të mirë të interesit publik.
- të përmbahemi nga përfshirja në çfarëdo biznesi apo transaksioni apo nga të pasurit e çfarëdo interesi financiar apo interesi tjetër personal, që është apo mund të dalë të jetë në përputhje jo të plotë me kryerjen e detyrave zyrtare.
- të shmangim nepotizmin dhe favorizimin në punësim dhe ofrimin e shërbimeve.
- të përmirësojmë konsiderueshëm politikat tona parandaluese të korrupsionit duke zbatuar me përpikëri planin e integritetit.
- të përmbahemi nga çfarëdo sjellje që mund të humbë vlerën e imazhit të integritetit apo profesionalizmit të AMMK-së.

Andaj, unë deklaroj përkrahjen time të plotë dhe përkushtimin tim maksimal për të gjitha përpjekjet që fuqizojnë, zhvillojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht sistemin e menaxhimittë integritetit brenda AMMK.

Afrim Berisha, Zëvendësues i Drejtorit Ekzekutiv i AMMK

2. Parimet e menaxhimit të Integritetit

2.1. Lidershipi

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshme të demonstrojë një përkushtim aktivtë bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit. Është shumë e rëndësishme që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm në mënyrë që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjitha palët e interesit, të jashtme dhe të brendshme.

2.2. Përfshirja e personelit

Është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e secilit punëtor në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i jashtëm dhe i brendshëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

2.3. Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kërkohet nga organizatat që të kushtojnë vëmendje të gjitha komponentëve të sistemit dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre.

3. Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe të rendisë përpjekjet dhe burimet për të zvogëluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në AMMK.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një platforme ku të gjithë individët dhe njësitë në AMMK si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të AMMK.
- Krijimi i vetëdijes së publikut mbi rreziqet e korrupsionit, sensibilizimi i qytetarëve dhe bizneseve për rolin e tyre në zvogëlimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.
- Përmirësimi i raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në AMMK.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike si dhe forcimi i sundimit të ligjit.

4. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson ligjshmërinë e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i cenueshmërisë të identifikuar dhe të vlerësuar për të gjitha fushat e funksionimit të AMMK.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar cenueshmërinë e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i cenueshmërisë së integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të AMMK. Të gjithë të punësuarit kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të AMMK dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

4.1. Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa fazave si në vijim:

- **Faza përgatitore** – Gjatë kësaj periudhe kohore është themeluar grupi punues (vendimi nr.130, AMMK i datës 20.09.2023), përmes së cilit është emëruar koordinatori kryesor për zhvillimin e planit të integritetit dhe personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit, është informuar Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Gjatë kësaj periudhe janë mbledhur informacionet e nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit, si dhe janë informuar të gjithë punonjësve për fillimin e hartimit të Planit të Integritetit dhe rëndësinë e tij. Më shumë detaje janë paraqitur në tabelën 1.

Tabela 1: Faza përgatitore për hartimin e Planit të Integritetit

Nr.	Faza e hartimi	Aktiviteti	Personi përgjegjës	Data
1.	Faza përgatitore	Formimi i grupit punues për hartimin e Planit të Integritetit	Drejtorit Ekzekutiv i AMMK	20.09.2023
2.	Faza përgatitore	Njoftimi i Agjencionit për Parandalimin e Korrupsionit për formimin e grupit punues dhe	Drejtorit Ekzekutiv i AMMK	20.09.2023
3.	Faza përgatitore	Mbledhja e informatave për përgatitjen e planit të Integritetit	Grupi punues	20 Shtator -20 Tetor 2023
4.	Faza përgatitore	Informimi i punëtorëve lidhur me fillimin e punës për përgatitjen e Planit të Integritetit	Drejtorit Ekzekutiv i AMMK & Grupi punues	20.10.2023

- **Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit** – gjatë kësaj faze (tetor 2023) koordinatori së bashku me grupin punues ka mbajtur takime të punës ku janë analizuar dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së AMMK, përshkrimete punës dhe fushëveprimin e çdo njësie) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe në koordinim me menaxhmentin e AMMK grupi punues ka përcaktuar fushat e rrezikut si dhe ka bërë identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve si dhe ka hartuar draftin fillestarë të planit të integritetit. Më shumë detaje janë paraqitur në tabelën 2.

Tabela 2: Faza e zhvillimit për hartimin e Planit të Integritetit

Nr.	Faza e zhvillimit	Aktiviteti	Personi përgjegjës	Data
1.	Vlerësimi i ekspozimit të rrezikut	Kompletimi i pyetësori	Grupi punues	Tetor 2023
2.	Hartimi i dokumentit	Hartimi i draftit të parë të dokumentit	Grupi punues	26.10.2023
3.	Informimi mbi draftin e parë të dokumentit	Informimi i njësive të AMMK lidhur me draftin e Planit të Integritetit	Drejtorit Ekzekutiv i AMMK & Grupi punues	06.10.2023
4.	Plotësimi i dokumentit	Plotësimi i dokumentit të Planit të Integritetit	Grupi punues	06.10. 2023-10.10.2023

- Faza e përcaktimit të prioriteteve, dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit** – gjatë kësaj faze (nëntor 2023) grupi punues së bashku me menaxhmentin e AMMK ka bërë përcaktimin e prioriteteve për intervenim, përcaktimin e masave për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve dhe përgjegjësit për zbatim si dhe ka hartuar draftin e planit të integritetit. Në këtë fazë është bërë edhe konsultimi i draftit të planit me njësitet e AMMK dhe me palët tjera të interesit përfshirë edhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Vërejtjet dhe plotësimet gjatë konsultimeve me palët e interesit janë përfshirë në versionin final të planit të integritetit të AMMK në takimin e mbajtur me datën 20.11.2023. Grupi punues ka përgatitur njoftimin final dhe shkresën përcjellëse për Zëvendësuesin e Drejtorit Ekzekutiv të AMMK Planit të Integritetit (shkresa nr. e datës 21.11.2023) Planit të Integritetit është miratuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit Ekzekutiv i (vendimi nr.179/AMMK/2023 i datës 06.12.2023).

Tabela 3: Faza e finalizimit të Planit të Integritetit

Nr.	Faza e finalizimit	Aktiviteti	Personi përgjegjës	Data
1.	Konsultimi me njësitet e AMMK lidhur me draftin	Pranimi i komenteve dhe përfshirja e tyre në draftin e dokumentit	Grupi punues	16.10.2023-27.10.2023
2.	Konsultimi me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit	Pranimi i komenteve dhe përfshirja e tyre në draftin e dokumentit të Planit të Integritetit	Drejtorit Ekzekutiv i AMMK & Grupi punues	23.10.2023

3.	Finalizimi i dokumentit	Përgatitja e draftit final të Integritetit	Grupi punues	06.11.2023-15.11.2023
4.	Raporti përfundimtarë	Raporti final nga Grupi punues për finalizimin e dokumentit	Grupi punues	21.11.2023

- **Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit** – kjo fazë do të zbatohet pas aprovimit të planit të integritetit dhe përfshin monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan. Kjo fazë përfshinë edhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimin e aktiviteteve që mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve për përmirësimin e zbatimit të Planit të Integritetit.

4.2. Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut është bërë duke renditur rreziqet më të mëdha në krye të listës. Këto rreziqe paraqesin efekte thelbësore në integritetin e AMMK dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të AMMK. Ky klasifikim i rreziqeve ka qenë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet janë përcaktuar ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, janë vendosur aty ku është vërejtur se janë më të nevojshme.

Në përgjithësi, për rreziqet e kategorizuara si të vogla, që përputhen me standardet për marrje të rrezikut, nuk kanë imponuar nevojën për masa shtesë të trajtimit, por janë trajtuar duke vendosur mekanizma të monitorimit të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Ndërsa për rreziqet madhore është zbatuar një trajtim i menjëhershëm duke vendosur zbatimin e masave adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grupi punues ka përcaktuar nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuar dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut.

Niveli përfundimtar i rrezikut është përcaktuar bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

4.2.1. Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë apo në aktivitetet e AMMK për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha çështjet që mund të shkojnë keq dhe duke peshuar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë priorizimin e çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve, masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushën, aktivitetin e AMMK në rrugë të mbarë.

Përshkrimi më i detajuar i matricës së vlerësimit të rrezikut të përdorur në procesin e llogaritjes së rrezikut për aktivitetet e AMMK është prezantuar në tabelën 4.

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në tabelën vijuese.

Tabela 4 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja /Ndikimi	Madhor	10									
		9									
		8									
	Mesatar	7									
		6									
		5									
		4									
	Vogël	3									
		2									
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Intenziteti irrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar			Lartë			
		Probabiliteti/Gjasat									

4.2.2. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, bazuar në vlerësimet e prezantuara në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 – 100

 Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

5. Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të organizatës. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu monitorimi do të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetet e rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimet duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Përmes raportimit të rregullt, do të sigurohet se zbatimi i Planit po bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të planit të integritetit, janë krijuar mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

1. **Menaxheri i Integritetit** – është emëruar me vendim të Drejtorit Ekzekutiv të AMMK dhe është përgjegjës për:

- promovimin e integritetit në AMMK dhe merr masa për të parandaluar korrupsionin, konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike të punonjësve.
- mbajtjen e Planit të Integritetit në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit.
- zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar dhe luftimi në mënyrë proaktive të kërcënimeve ndaj integritetit.
- pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike.
- propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike.
- sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur zbatimin e planit.

- mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave për përmirësimin e integritetit.
- në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit.
- raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit.

Menaxheri i Integritetit raporton:

- tek Drejtori Ekzekutiv i AMMK çdo 6 muaj mbi zbatimin e Planit të Integritetit dhe masat përmirësues që duhet ndërmarr nga Drejtorët për periudhën e ardhshme.

2. **Koordinatori dhe grupi punues** – janë emëruar me vendim të drejtorit ekzekutiv të AMMK dhe janë përgjegjës për:

- përgatitjen e programit për hartimin e Planit të Integritetit.
- mbledhjen dhe analizimin e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të AMMK, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit.
- konsultimet me grupe relevante të interesit nga sektori publik, operatorët, shoqëria civile dhe qytetarët me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit.
- hartimin e draftit të Planit të Integritetit dhe prezanton tek stafi i AMMK për komente.
- finalizimin e draftit të Planit të Integritetit dhe dërgimin e tij për miratim te Drejtorit Ekzekutiv i AMMK.

6. Fushat e rrezikut

6.1 Fushat e përgjithshme të Rrezikut

- 6.1.1 Drejtimi dhe menaxhimi i të punësuarve.
- 6.1.2 Planifikimi dhe menaxhimi financiar.
- 6.1.3 Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve.
- 6.1.4 Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve.

6.2 Fushat e Veçanta të Rrezikut

- 6.2.1 Auditimi i brendshëm.
- 6.2.2 Prokurimi publik.
- 6.2.3 Ofrimi i shërbimeve për palët e jashtme.
- 6.2.4 Komunikimi me palët e jashtme të interesit.
- 6.2.5 Monitorimi i gjendjes së mjedisit.
- 6.2.6 Administrimi i parqeve kombëtare.

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT									
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut				Veprimi ndaj rrezikut		
Nr.	Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësim i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/ zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	DREJTIMI DHE MENAXHIMI	Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të AMMK të padefinuara dhe mos përfshirja e të gjitha fushave përkatëse për zhvillimin e AMMK në Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës	Ligjet dhe aktet nënligjore, Raportet periodike; Aktet e brendshme të AMMK, Plani i Integritetit	5	9	45	Zhvillimi i metodologjisë për hartimin e Planit Zhvillimor të AMMK dhe zbatimin e saj.	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtorët e Drejtorive te AMMK	Deri në tremujorin e fundit 2024
						Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të të gjitha fushave përkatëse në zhvillimin e Planit Zhvillimor të AMMK			
		Krijimi opinion publik jo të mirë dhe humbja e besimit të publikut në punën e AMMK për shkak të transparencës së pamjaftueshme		2	7	14	Përditësimi i informatave në ueb faqen e AMMK për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e AMMK	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtorët e Drejtorive te AMMK	Tremujori i fundit 2026
						Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me informacionet te rëndësishme dhe me interes publik	Spektori për Raportim dhe Informim në bashkëpunim me Drejtorin dhe Drejtorët e Drejtorive te AMMK	Tremujori i fundit 2026	
		Mosdefinimi i qatë i përgjegjësi në		3	8	24	Rishikimi i organizimit të brendshëm të AMMK	Drejtorët e Drejtorive të	Deri në tremujorin e

		drejtoritë e AMMK					përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.	AMMK dhe grupi punues përkatës në bashkëpunim me divizionin e personelit të MMPHI	dytë 2024
2.	POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË PUNËSUARV E	Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm	Ligjet dhe aktet nënligjore, Raportet periodike; Aktet e brendshme të AMMK, Plani i Integritetit	2	7	14	Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit	Drejtorët e Drejtorive të AMMK bashkëpunim me divizionin e personelit të MMPHI	Dhjetor të çdo viti gjate periudhës 2024-2026
		Profesionalizmi dhe kompetenca e pamjaftueshme e të punësuarve.		3	6	18	Zbatimi i parimit të meritës gjatë procedurave të punësimit	Njësia e Burimeve Njerëzore	Dhjetor të çdo viti gjate periudhës 2024-2026
							Të bëhet analiza e nevojave për trajnime	Njësia e Burimeve Njerëzore, Drejtuesit e drejtorive	
							Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave		
							Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura		
		Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa definuara sipas rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës		2	7	14	Të bëhet rishikimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.	Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e Drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve.	Deri në tremujorin e tretë 2024
							2	7	14

							Udhëheqësit e sektorëve		
				2	7	14	Të ju ri-dorëzohet përshkrimi i vendit të punës të gjithë nëpunësve	Divizioni i Burimeve Njerëzore, Të gjithë nëpunësit	Deri në tremujorin e tretë 2024
		Mungesa e Kodit të etikës për gjithë zyrtarët përfshirë zyrtarët publik dhe të punësuarit tjerë		2	8	16	Monitorimi i zbatimit të obligimeve dhe të drejtave sipas legjislacionit në fuqi për gjithë zyrtarët përfshirë zyrtarët publik dhe të punësuarit tjerë	Divizioni i Burimeve Njerëzore	Dhjetor të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026
		Mungesa e informimit dhe mos raportimit të dhuratave nga qytetarët tek punëtorët e AMMK (neni 17 dhe 18 i Rregullore (QRK - Nr. 04/2015 Për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës)		4	6	24	Divizioni për Burime Njerëzore krijon një regjistër për regjistrimin e dhuratave të pranuar nga nëpunësit; Të informohet stafi për rregullat e pranimit të dhuratave.	Divizioni i Burimeve Njerëzore, Të gjithë nëpunësit publik	Dhjetor të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026
		Niveli i pamjaftueshëm i ndërgjegjësimit të punonjësve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme brenda institucionit.		7	7	49	Të sigurohet mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme.	Divizioni i Burimeve Njerëzore, Drejtori ekzekutiv i AMMK dhe drejtuesit e drejtorive	Shkurt të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026

3.	PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMII BUXHETIT DHE FINANCAVE	Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor të AMMK.	Ligjet dhe aktet nënligjore, Raportet periodike; Aktet e brendshme të AMMK, Plani i Integritetit	2	7	14	Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit;	Divizioni për Buxhet dhe Financa	Tetor-Nëntor të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026	
		Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit					Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Divizioni për Buxhet dhe Financa			
		Shpenzimi i buxhetit në mënyrë jo fikasë dhe mos prioritizimi i nevojave			2	7	14	Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve	Drejtori ekzekutiv i AMMK dhe Divizioni për buxhet dhe financa	Janar të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026
								Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore.	Divizioni për Buxhet dhe Financa	Janar të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026
								Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e AMMK	Njësia për informim	
								Të sigurohet mbikëqyrja mbi zbatimin e buxhetit nga ZKF	Divizioni për Buxhet dhe Financa dhe ZKF	Çdo 3 muaj
								Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit	Drejtorja për Buxhet dhe Financa	Çdo 6 muaj
		Inventarizimi dhe regjistrimi i aseteve të AMMK			5	6	30	Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të AMMK	Divizioni për Buxhet dhe Financa	Deri në tremujorin e dytë 2024
4.	RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACIONIT	Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe	Ligjet dhe aktet nënligjore, Raportet periodike;	4	9	36	Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Sektori i SIM	Janar të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026	

		përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare	Aktet e brendshme të AMMK, Plani i Integritetit				Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rrezikut nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara.	Sektori i SIM	Shkurt të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026
FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT TË RREZIKUT									
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut				Veprimi ndaj rrezikut		
Nr.	Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistues e të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/ zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	AUDITIMI I BRENDSHËM	Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti	Ligjet dhe aktet nënligjore, Raportet periodike; Aktet e brendshme të AMMK, Plani i Integritetit	2	8	16	Të sigurohet planifikim efektiv i auditimit i bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe të monitorohet zbatimi i këtij plani si dhe të planifikohen masa përmirësuese në rast nevojë.	Drejtori Ekzekutiv i AMMK, Njësia e auditimit	Qershor të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026
							Të sigurohen auditime rast pas rasti për të vërtetuar të gjeturat gjatë auditimeve		
		Mungesa e mbikëqyrjes adekuate, profesionale mbi zbatimin e rekomandimeve		3	9	27	Zhvillimi i një plani për zbatimin e rekomandimeve të auditimit	Drejtori Ekzekutiv i AMMK dhe Drejtorët e Drejtorive	Dhjetor të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026
							Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit	Grupi Punues dhe Drejtorët e drejtorive	Dhjetor të çdo viti gjatë periudhës

		Mungesa e koordinimit ndërmjet Njesisë së AB, Drejtorit ekzekutiv të AMMK dhe Drejtorëve të Drejtorive		3	8	24	Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera.	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtorët e Drejtorive dhe Njësia e AB	2024-2026
2.	PROKURIMI PUBLIK	Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit	Ligjet dhe aktet nënligjore, Raportet periodike; Aktet e brendshme të AMMK, Plani i Integritetit	6	8	48	Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit duke marrë parasysh kriteret për mos-diskriminim dhe duke siguruar qasje të barabartë.	Divizioni i prokurimit, Drejtorët e drejtorive, Divizioni i burimeve njerëzore	Në baza vjetor gjatë periudhës 2024-2026
							Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për prokurimin publik	Divizioni i prokurimit, Drejtorët e drejtorive, Divizioni i burimeve njerëzore	Në baza vjetor gjatë periudhës 2024-2026
		Mbikëqyrja e pa mjaftueshme e prokurimit publik		3	8	24	Publikimi i Planit të Prokurimit në ueb faqen e AMMK	Njësia e prokurimit	Shkurt të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026
							Të caktohen auditime pas prokurimit dhe dhënies së kontratës për tenderë për të rishikuar respektimin e standardeve të specifikuara procedurale	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Njësia e Auditimit të Brendshëm	Në baza tre mujore gjatë periudhës 2024-2026
							Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin me ofertuesit dhe duke krijuar	Drejtori ekzekutiv i AMMK dhe Divizioni i prokurimit	Tremujori i fundit i 2024

		Menaxhimi joefikas dhe jo profesional i kontratave/ projekteve		7	7	49	pika të qarta të kontaktit Krijimi i njësisë për Menaxhimin e Projekteve dhe Trajnimi i personelit për menaxhimin e kontratave/projektit	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Divizioni prokurimit dhe Divizioni i Burimeve Njerëzore	Tremujori i fundit i 2025
3	OFRIMI I SHËRBIMEVE PËR PALËT E JASHTME	Efikasitetit, efektivitetit, cilësia dhe transparencës jo e kënaqshme në ofrimin e shërbimeve për palët e jashtme	Ligjet dhe aktet nënligjore, Raportet periodike; Aktet e brendshme të AMMK, Plani i Integritetit	5	8	40	Të hartohen aktet nënligjore si dhe qartësimi i procedurave për ofrimin e shërbimeve përkatëse për palët e jashtme	Drejtorët e drejtorive të AMMK	Tremujori i fundit i 2026
							Të krijohen aplikacione elektronike për ofrimin e shërbimeve për palët e jashtme në mënyrë elektronike	Sektori i SIM	Tremujori i fundit i 2026
							Të rritet profesionalizmi i stafit përmes trajnimeve, shkëmbimit të përvojave, punëtorive	Drejtoritë e AMMK, Divizioni i Burimeve Njerëzore	Në baza vjetor gjatë periudhës 2024-2026
4.	KOMUNIKIMI ME PALËT E JASHTME TË INTERESIT	Mungesa e konsultimeve të mjaftueshme me palë të jashtme të interesit gjatë hartimit të rregulloreve dhe buxhetit	Ligjet dhe aktet nënligjore, Raportet periodike; Aktet e brendshme të AMMK, Plani i Integritetit	2	8	16	Të rritet transparenca dhe të merren masa për konsultime me palë të jashtme të interesit gjatë zhvillimit të rregulloreve, planeve dhe akteve nënligjore dhe postimi i tyre në ueb faqe, organizimi i debateve publike	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtoritë e AMMK, Sektori për Raportim dhe Informim	Tremujori i fundit i 2026
		Partneriteti i pamjaftueshëm me shoqërinë civile në fushën e anti-		5	9	45	Të zhvillohen partneritete me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit duke themeluar grupe	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtoritë e	Tremujori i fundit i 2025

		korrupsionit dhe bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve					pune teknike për menaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj korrupsionit dhe të sigurohet përfshirja e shoqërisë civile	AMMK, Sektori për Raportim dhe Informim				
							Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes takimeve periodike konsultative	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtoritë e AMMK, Sektori për Raportim dhe Informim	Në baza vjetor gjatë periudhës 2024-2026			
							Të rritet rrjedha e informacionit drejt medias dhe publikut lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe të aktiviteteve të luftës kundër tij.	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtoritë e AMMK, Sektori për Raportim dhe Informim	Në baza mujore gjatë periudhës 2024-2026			
5	MONITORIMI I GJENDJES SË MJEDISIT	Mungesa e planifikimit të duhur për monitorimin e gjendjes së mjedisit					3	7	21	Të sigurohet plani vjetor i punës dhe plan i monitorimit për çdo sektor duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut.	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtoritë e AMMK	Shkurt të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026
Mungesa e kapaciteteve profesionale te stafit që merret me monitorimin e mjedisit		5					8	40	Organizimi i trajnimeve profesionale për stafin e AMMK që merret me monitorimin e mjedisit	Drejtoritë e AMMK, Divizioni i burimeve njerëzore, Donatorët	Në baza vjetor gjatë periudhës 2024-2026	
Numër i pamjaftueshëm i stafit		3					8	24	Të sigurohet numër i mjaftueshëm i	Drejtori ekzekutiv i	Deri në fund të vitit 2024	

		për monitorimin e gjendjes së mjedisit për disa sektorë					zyrtarëve të AMMK sipas kërkesave të monitorimit për të gjithë sektorët	AMMK, Drejtoritë e AMMK Divizioni i burimeve njerëzore	
		Mungesa e pajisjeve për monitorimin e gjendjes së mjedisit		3	8	24	Të sigurohet pajisjet e nevojshme për monitorimin e gjendjes së mjedisit	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtoritë e AMMK Divizioni i buxhetit dhe financave	Deri në fund të vitit 2024
6	ADMINISTRIMI I PARQEVE KOMBËTARE	Mungesa e rojtarëve të natyrës për të mbuluar kontrollin e gjithë territorit të parqeve		5	7	35	Të shtohet numri i rojeve për kontrollin e territorit të parqeve sipas standardeve për menaxhimin e PK	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtoritë e PK, Divizioni i buxhetit dhe financave	Deri në fund të vitit 2026
		Bashkëpunimi jo i mjaftueshëm me palët e interesit		4	6	24	Mbajtja e takimeve të rregullta me Agjencinë e Pyjeve, Komunat, Policinë e Kosovës, Prokurorinë, dhe me Organizatat e Shoqërisë Civile në funksion të përmirësimit të bashkëpunimit	Drejtoritë e Parqeve Kombëtare	Në baza gjashtëmujorë gjatë periudhës 2024-2026
		Mosdefinimi i qartë i kompetencave për mbrojtjen e pyjeve dhe tokave pyjore ne		6	7	42	Të plotësohet dhe ndryshohet rregullorja për rendin e brendshëm të Parqeve Kombëtare bazuar	Drejtoritë e Parqeve Kombëtare, Zyra ligjore e	Deri në fund të vitit 2024

		territorin e parqeve kombëtare					në kërkesat e ligjit të natyrës	MMPHI	
							Të përgatiten planet menaxhuese për PK dhe planet rregullues për zonat e veçanta në PK	Drejtoritë e Parqeve Kombëtare, Zyra ligjore e MMPHI, IPH	Deri në fund të vitit 2027
		Mungesa e pajisjeve dhe infrastrukturës në territorin e Parqeve Kombëtare		3	3	9	Vendosja, aktivizimi dhe mirëmbajtja e laurave në pikat hyrëse të PK dhe digjitalizimi i sistemit të hyrje daljeve në laura	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtoritë e PK Divizioni i buxhetit dhe financave	Deri në fund të vitit 2026
							Shenjëzimi i territorit të PK dhe vendosja e tabelave informuese sipas zonave përkatëse dhe në hyrje dalje të territorit të parqeve	Drejtori ekzekutiv i AMMK, Drejtoritë e PK Divizioni i buxhetit dhe financave	Deri në fund të vitit 2026
							Shenjëzimi i shtigjeve për turistët dhe vendosja e shenjave informuese	Drejtoritë e PK Divizioni i buxhetit dhe financave	Deri në fund të vitit 2026
Blerja e pajisjeve dhe mjeteve për rojet dhe stafin tjetër të PK për monitorimin dhe kontrollin e territorit të PK	Drejtoritë e PK Divizioni i buxhetit dhe financave	Shtator-tetor të çdo viti gjatë periudhës 2024-2026							

Plani për Integritet 2024-2026,
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Adresa e AMMK-së:
Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04

Kontakti:

Tel. +381 38 200 33 228
Email: ammk@rks-gov.net

Prishtinë, dhjetor 2023